

E DREJTA PËR INFORMIM

Këshilli i Evropës vlerëson zbatimin e Konventës 205 nga Shqipëria



Grupi i Aksesit në Informacion (Access Info Group-ALG), organizmi i ekspertëve të Konventës së Këshillit të Evropës (KiE) “Për aksesin në dokumentet zyrtare” (Konventa e Tromsø) vlerëson pozitivisht Shqipërinë në zbatimin e parashikimeve të këtij dokumenti. I mbledhur në Strazburg në datat 13-15 nëntor 2024, ky organizëm paraqiti Raportin e Vlerësimit për vendin tonë, i cili përcakton nivelin e

përputhshmërisë dhe garancive të parashikuara në ligjin 119/20214 “Për të drejtën e informimit” me ato që parashikon Konventa e Tromsø. Raporti konstaton nivelin bashkëkohor të masave që kuadri rregullator shqiptar përmbush për garantimin e ushtrimit praktik të të drejtës për informim, si një nga liritë dhe të drejtat themelore të qytetarit.

Ligji nr. 45/2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare” përcakton institucionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si organin përfaqësues të Shqipërisë në Këshillin e Palëve.

PËRMBLEDHJE MUJORE E VENDIMEVE

Vendim Nr. 25 - [Banka e Shqipërisë](#)

Vendim Nr. 26 - [Bashkia Vlorë](#)

Vendim Nr. 27 - [Bashkia Pukë](#)

Vendim Nr. 29 - [Universiteti i Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”](#)

Vendim Nr. 31 - [Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet](#)

PËRMBLEDHJE MUJORE E REKOMANDIMEVE

Rekomandim Nr. 24 - [Agjencia për Dialog dhe
Bashkëqeverisje](#)

Rekomandim Nr. 25 - [Agjencia e Inovacionit dhe
Ekselencës](#)

Rekomandim Nr. 26 - [Agjencia Shtetërore e
Programit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
\(SASPAC\)](#)

Rekomandim Nr. 27 - [Korporata e Investimeve
Shqiptare Sh.a](#)

Rekomandim Nr. 28 - [Agjencia Shtetërore për
Mbështetjen dhe Zhvillimin e Start-up-eve dhe
Lehtësuese](#)

Rekomandim Nr. 29 - [Autoriteti Kombëtar i
Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin
Civil](#)

Rekomandim Nr. 30 - [IdentiTek Sh.a](#)

Rekomandim Nr. 31 - [Operatori i Blerjeve të
Përqendruara Sh.a](#)

Rekomandim Nr. 32 - [Agjencia e Mbikëqyrjes
Policore](#)

Rekomandim Nr. 33 - [Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të Cannabis-it](#)



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit nëntor 2024



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit nëntor 2024, ka dhënë 5 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

Me vendimin nr. 31, datë 21.11.2024, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet" (në vijim Autoriteti Publik"), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës, depozituar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni, në lidhje me "Raportet vjetore të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi për vitet 2016 – 2023". MShMS ka përcjellë për kompetencë dhe trajtim, pranë Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet kërkesën për informacion të sipërcituar.

Autoriteti Publik, ka kthyer përgjigje duke bërë me dije se: "Kërkuar duhet të saktësojë informacionin publik, i cili përbën interesin për të, sepse "Raporti Vjetor i ZMR/KMR" përmban informacione për të dhëna personale apo tregtare të subjekteve fizikë dhe juridikë që trajtohen në bazë të ligjit nr. 9887, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Pas saktësimit të kërkesës, informacioni do t'i përcillet Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi si organ vendimmarrës që të shprehet në lidhje me këtë çështje".

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, kërkuar me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"). Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Komisioneri, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion.

Autoriteti Publik, ka kthyer përgjigje duke i qëndruar përgjigjes së parë dhe duke argumentuar ndër të tjera se: "...KMR nuk ka detyrim ligjor publikimin e Raporteve Vjetore të KMR, të cilat nuk publikohen prej vitit 2013, për shkak të të dhënave apo informacionin që përmbajnë këto raporte, në lidhje me burimet radioaktive, informacion të cilin nuk mund ta ketë kushdo. Mbështetur në ligjin 8853, për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën ndërkombëtare për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore" si dhe ligjit nr. 88/2013 për ratifikimin e ndryshimeve të konventës "Për mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore", parimi themelor i tyre është konfidencialiteti.

Pas konsultimit të legjislatorit të psaçëm, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ dhe qëndrimit të mbajtur nga Autoriteti Publik, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara për ankesën, nuk janë në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI. Në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: "Autoritet publik" është çdo organ

administrativ i parashikuar në legjisllacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisë të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj". Në kuptim të këtij parashikimi, MShMS/ZMR është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Lidhur me argumentat e parashtruara nga Autoriteti Publik se, "...bazuar në nenin 17 dhe 15 pika 3/c të LDI, i është bërë me dije të saktësojë konkretisht çfarë informacioni publik, përbën interesin për të, sepse ky dokument përbën të dhëna sensitive dhe personale për subjektet dhe si e tillë, kërkesa për informacioni do t'i përcillet KMR për trajtim, si autoriteti vendimmarrës dhe që administron këtë dokument", Komisioneri vlerëson se ky argument është i gabuar pasi bazuar në pikën 1 të nenit 12 të LDI në të cilës parashikohet se: "Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuarin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuarin në saktësimin e kërkesës", Autoritetit Publik i jepet mundësia që në rastet kur është i paqartë mbi informacionin e kërkuar, t'ë kërkojë saktësimin e tij, te kërkuar.

Rezulton që kjo procedurë e kryer nga Autoriteti Publik nuk qëndron edhe pse në vlerësim të Komisionerit objekti i kërkesës për informacion është mëse i qartë. Gjithashtu, bazuar në pikën 1 të nenit 3, Ligji nr. 9887/2008 për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, emrat e subjekteve të regjistruar si person fizik ose juridik në bazë të legjisllacionit përkatës tregtar, nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj. Ndërkohë, "Të dhëna sensitive" në kuptim të pikës 4 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

Kërkesa për informacion konsiston në vendosjen në dispozicion të Kopje të Raporteve Vjetore të Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi, të cilat nuk përmbajnë elementë të përfshira në parashikimin e mësipërm. Rezulton se, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar mos dhënien e informacionit mbi këtë dispozitë. Parimi i konfidencialitetit në Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore (CPPNM) synon të mbrojë informacionin sensitiv dhe kritik që lidhet me sigurinë bërthamore, por kurrsesi ky parim nuk duhet të pengojë transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucioneve publike, të bëjë publike Raportet Vjetore, detyrim i cili buron në bazë të pikës 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 123.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar në parim përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI.

Në këto kushte Autoriteti Publik duhet të vendosi në dispozicion të kërkuarit informacionin e kërkuar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar.

Në përfundim Komisioneri ka vendosur pranimin e ankesës dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar nga ankuesi.

Ushtrimi në praktikë i të drejtave, bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë



Shkolla "Transparenca dhe Qeverisja e Hapur 2024" është një program i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, që ka në fokus jo vetëm njohjen me kuadrin ligjor kombëtar por edhe zbatimin e tij në praktikë nga profesionistët e së ardhmes.

I ftuar në këtë aktivitet ishte edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, i cili mbajti një leksion të hapur për garantimin e të drejtës për informim në vendin tonë dhe mbi rolin e veprimtarinë institucionale në këtë fushë. Në prezantimin e tij, Komisioneri vlerësoi se procesi i transparencës së autoriteteve publike rrit përgjegjshmërinë e tyre, nxit llogaridhënien e vazhdueshme dhe mundëson pjesëmarrjen efektive të qytetarëve në qeverisje. Në këtë këndvështrim, ai theksoi se edhe digjitalizimi i shërbimeve publike është shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për ta forcuar akoma edhe më shumë në praktikë konceptin e transparencës.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, një grup studentësh pjesëmarrës në këtë Shkollë, ishin të pranishëm gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore me autoritete publike. Njëkohësisht, ata u njohën edhe me kuadrin ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, procesin e modernizimit të tij dhe me trajtimin e rasteve konkrete. Në këtë mënyrë, Zyra e Komisionerit jep kontributin e saj në formimin sa më të plotë me njohuri dhe praktikat më të mira, në funksion të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve



Për një proces zgjedhor transparent dhe në respekt të të drejtave të qytetarëve



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, ishte i ftuar në takim "Zgjedhjet 2025: roli i medias në procesin zgjedhor, sfida dhe mundësi". Kjo tryezë teknike u bashkëorganizua nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Prezenca e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), e cila kishte në fokus procesin përgatitor për

zgjedhjet e vitit të ardhshëm për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Në sesionin e dytë të këtij aktiviteti me temë "Gjetjet kryesore dhe rekomandimet nga institucionet shtetërore dhe aktorë të tjerë", në fjalën e tij, z. Dervishi, ndër të tjera theksoi se pavarësisht se Zyra e Komisionerit nuk ka detyra të posaçme përsa i përket proceseve zgjedhore, për të dy fushat e veprimtarisë së institucionit ka një përvijë shumë të rëndësishme të bashkëpunimit me KQZ.

"Në kuptim të legjislacionit për të drejtën e informimit është një 'autoritet publik'- shumë i rëndësishëm në kuadër të rolit në proceset zgjedhore. Nga ana tjetër, në fushën e mbrojtjes së të dhënave, në cilësinë e 'kontrolluesit' përpunon një sasi shumë të madhe të dhënash personale të qytetarëve. Siç e dini, legjislacioni për të drejtën e informimit parashikon instrumentin e 'Programit të Transparencës'. Duhet të forcojmë përpjekjet që ky instrument t'i paraprijë informacionit, për qytetarin, në rradhë të parë dhe natyrisht, edhe për median. Në këtë mënyrë, përsosim akoma edhe më shumë funksionimin e konceptit të transparencës. Ne kemi miratuar, mbështetur në opinionet e Këshillit të Evropës dhe Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave, një Udhëzues që e kemi prezantuar me KQZ përpara zgjedhjeve të fundit vendore. Ky është një dokument shumë i rëndësishëm, për partitë politike në rradhë të parë, por edhe për të gjithë ne aktorët dhe faktorët që japim kontributin tonë gjatë procesit të zgjedhjeve. Ka një aspekt themelor që partitë politike duhet të respektojnë, parimin 'e mjaftueshmërisë' së të dhënave, pikërisht këtu fillon vendosja e barrierës së mbrojtjes së të dhënave dhe parandalimi i keqpërdorimit të tyre. Janë koncepte deri diku të reja, por kemi filluar t'i promovojmë dhe i kemi kërkuar me vendosmëri".

Tryeza teknike është një përpjekje për të rritur integritetin e zgjedhjeve të ardhshme, si dhe për të forcuar zbatimin e dispozitave ligjore dhe rregullave në pasqyrimin profesional dhe të paanshëm të tyre.



Pjesëmarrja e Zyrës së Komisionerit në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në edicionin e 30-të të Panairit Ndërkombëtar të Tiranës (PNT30), në datat 6-9 nëntor 2024. Ky aktivitet shërbeu si një platformë informimi dhe ndërveprimi mes komuniteteve të biznesit dhe jo vetëm, për të krijuar ura bashkëpunimi mes tyre dhe institucioneve publike.

Pjesë e agjendës së këtij Panairi ishin edhe takime, seminare e trajnime për shkëmbimin e ideve dhe prezantimin e praktikave më të mira, ku në panelin me temë "*Sistemi bankar në Shqipëri, sfidat e digjitalizimit*" ishte e ftuar dhe Zyra e Komisionerit. Në të u trajtuan çështje me interes që kanë të bëjnë, kryesisht, me masat tekniko-organizative për ofrimin e garancive në përpunimin e sigurt të të dhënave personale nga shërbimet digjitale të këtij sektori. Kjo qasje do të rrisë ndërgjegjësimin, kulturën e transparencës dhe përgjegjshmërisë në ndërtimin e sistemeve funksionale. Nga ana tjetër, u nënvizua fakti se së shpejti pritet të finalizohet procesi i modernizimit të legjislacionit kombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale sipas standardeve të Bashkimit Evropian (GDPR). Po ashtu, të pranishmit theksuan edhe domosdoshmërinë për forcimin e dialogut dhe gjetjen e rrugëve të duhura mes komunitetit të biznesit dhe institucioneve publike për garantimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve.



Njëkohësisht, Zyra e Komisionerit u përfaqësua përgjatë 4 ditëve të zhvillimit të Panairit edhe me një stendë të posaçme. Kjo pjesëmarrje kishte si qëllim promovimin e rolit ndërgjegjësues, njohjen e veprimtarisë dhe funksioneve të institucionit, si dhe ndërveprimin e drejtpërdrejtë me kategori e grupe të ndryshme interesi.

Ndërveprimi me shoqërinë civile, për një sistem shëndetësor efektiv dhe transparent

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ishte e ftuar në prezantimin e “Raportit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë (SKSH) 2021-2030, arritjet dhe sfidat” i hartuar nga shoqata “Together for Life” (TfL). Ky dokument është një platformë e rëndësishme për zhvillimin dhe përmirësimin e këtij sistemi në vendin tonë që synon të sigurojë një kujdes shëndetësor cilësor, të aksesueshëm dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.



Në këtë takim, Zyra e Komisionerit mori vlerësime nga TfL për kontributin dhe mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit të mbledhjes së informacionit të domosdoshëm për hartimin e këtij raporti. Përfaqësuesit e institucionit theksuan se roli që ai luan në garantimin e së drejtës për informim do të ishte jo i plotë pa bashkëpunimin dhe ndërveprimin me organizatat e shoqërisë civile, për arritjen e objektivit të përbashkët, rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së autoriteteve publike.

Ky raport është i pari dokument monitorimi i hartuar që prej miratimit të SKSH 2021-2030, për vlerësimin e arritjeve dhe sfidave në zbatimin e politikave, objektivave specifike apo aktiviteteve të përcaktuara në këtë Strategji. Pjesë e takimit ishin aktorët kyç që kontribuojnë në sektorin shëndetësor, si përfaqësues të institucioneve politikbërëse, vendimmarrëse, atyre të pavarura, donatorëve, nga shoqëria civile dhe media.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



Komisioneri KDIMDP



IDP Albania



idp.albania



IDP Albania